Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo
Viti/na

REPUBLIKA E KOSOVËS : REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA
Pranuar - Primljeno Më/Dana 01.07.2024 vit.god.
| Nr.i organit Org.broj | Numri/Broj | Shtojcë Prilog | Vlera Vrednost |
| --- | --- | --- | --- |
| 01 | 110 | 05 | 924 |

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality

Kuvendi i Komunës së Vitisë në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2 pika d), dhe neni 40, paragrafi 40.2 pika d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 35, paragrafi 35.2, pika d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën 28.06.2024, miraton këtë:

# VENDIM

**për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) të Komunës së Vitisë, 2025-2027**

**Neni 1**

Me këtë Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) të Komunës së Vitisë, 2025-2027, duke u bazuar në Qarkoren Buxhetore 2025/01, të datës 15.05.2024 nga Ministria për Financa, Punë dhe Transfere, ku paraqet bazën për hartimin e buxhetit për vitin 2025-2027.

**Neni 2**

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) e Komunës së Vitisë 2025-2027 e hartuar nga Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim.

**Neni 3**

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset kryetari i komunës dhe Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim e Komunës së Vitisë.

**Neni 4**

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 8, lidhur me neni 9 të Rregullores Nr.10/2019 për procedurat e hartimi dhe publikimi të akteve të komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:
1. Zyrës së Kryetarit;
2. Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim; dhe
4. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
K R Y E S U E S I
Bekim Azizi